VENDIM
Nr. 210, datë 27.9.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË AEE SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 30.8.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 55/56 prot., datë 30.8.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 549/1 prot., datë 3.9.2018, ka përcjellë pranë subjektit AEE sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës.
- Aplikimi i shoqërisë AEE sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti